

TË MOS I MARRË ME VETE ATO QË DO TË SHKRUAJË"

(Nga kujtimet e Spiro Kolekës, maj 1988).

Shoku Enver Hoxha më tha këto fjalë, për dijetarin plak Spiro Konda, rreth viteve 1953 - 1954: "Konda plak ka kërkuar ndihmë, do të shkruajë për çështjen pellazgjike. T'i japim çdo ndihmë, se ai është një helenist i madh dhe njeri i ditur e i mirë. Ai ka punuar tërë jetën për këtë çështje. Edhe tani, që është rreth të nëntëdhjetave, rron me këto idera dhe ka dëshirë të madhe të shkruajë sa më parë një vepër shkencore. Ka shkuar tek shoku Myftar Grabocka e i ka shprehur dëshirën që të më njoftojë mua, se Prof. Spiro Konda është entuziazmuar e rinuar nga fitoret që ka arritur populli ynë nën udhëheqjen e Partisë në këta dhjetë vjet. Lutet që të ndihmohet, që të kryejë edhe ai detyrën e tij kundrejt atdheut e kundrejt shkencës. Duke me dërguar urime shpreh besimin se unë do t'i jap mundësitë, që të shkruajë e të nxjerrë veprën brënda një kohë të shkurtër. Unë, Spiro Kondën e kam njohur kur kam qënë në Korçë, si nxënës e si mësues. Kam pasur mendim të mirë për të, si njeri i ndershëm, me karakter të fortë dhe me dituri të madhe. Si helenist (njohës i thellë i greqishtes së vjetër) kemi tani tre vetë, më i moshuari është Konda e pas tij vijnë Thoma Papapanua, figurë e shquar e arsimit e atdhetar i vjetër dhe Sotir Papakristua, gjithashtu veprimtar i njohur i arsimit e përkthyes krijues i shkrimtarëve të vjetër grekë. Ushqej nderim të veçantë për këta dijetarët tanë të nderuar, të ditur dhe punetorë të palodhur. Konda është më plaku, po edhe Papapanua është afro shtatëdhjetë e pesë e Papakristua atë të shtatëdhjetave. Konda duhet ndihmuar. Unë i dhashë porosi të veçantë Myftarit, që t'i plotësojë të gjitha kërkesat e Kondës. I gjeti një sekretar me shkollë të lartë, i dha makinë shkrimi etj. etj. Konda fluturon nga gëzimi dhe nuk di si të falenderojë Partinë dhe mua. I është vënë menjëherë punës me një vullnet të habitshëm dhe me një punë të ngjeshur e sistematike, sikur të ishte gjashtëdhjetë e jo nëntëdhjetë vjeç. Kur të shkoj në Korçë do ta takoj dhe ti, që e ke merak çështjen pellazgjike dhe ke mësuar në shkollë edhe greqishten e vjetër, kujdesu, kur ta sjellë rasti, ta takosh, se i vjen mirë. T'i krijojmë, jo vetëm kushtet më të mira materiale, por edhe shpirtërore, që të mundet të japë sa më shumë në këtë fushë, të mos i marrë me vete ato që do të shkruajë".

Rreth kësaj çështjeje, të kërkesës së Kondës drejtuar shokut Enver Hoxha e porosive të veçanta që ishin dhënë e përkujdesjes së vazhdueshme të tij për punën e Kondës ishte në dijeni edhe Byroja Politike. Nuk e di mirë, por më duket se ishte vënë në dijeni edhe Instituti i Gjuhësise dhe i Historisë, që atë kohë, në se nuk gaboj ishin bashkë, për të dhënë ndonjë ndihmë. Sidoqoftë Instituti ishte në dijeni që Konda kishte kërkuar ndihmë të veçantë dhe shoku Enver Hoxha e kishte marrë nën kujdestari po të veçantë.

Shoku Myftar Grabocka ishte shumë entuziast për punën e Kondës. Ai e ndiqte me një përkujdesje të vazhdueshme, duke i vajtur rëndom në shtëpi plakut Konda e duke e kënaqur me fjalët e tij të ngrohta e me shakatë e të qeshurat me gjithë shpirt, që ishin në natyrën e Myftarit.

Herë pas here shoku Enver më thoshte : "Myftari me njofton se plaku Konda punon derrçe; ka filluar të shkruajë dhe puna po ecën". Më bëhej qejfi shumë dhe ndaj ai më vinte në dijeni.

E vërteta është që shoku Enver e moshatarët e tij, si unë e të tjerë, të lindur para shpalljes së Pavarësisë, ishim mbryjtur me mësimet e idetë e rilindasve tanë dhe prejardhja e popullit tonë nga pellazgët na ishte rrënjësuar thellë në shpirt. Kjo ishte edhe një krenari kombëtare, si gjatë Rilindjes, edhe në kohën e djalërisë tonë dhe këtë nuk e

kemi fahehur ose zbehur as më vonë. Edhe cilësimi nga Partia i popullit tonë, si "më i vjetri në Ballkan", nuk thotë atë që rilindasit e thoshnin shprehimisht "pasardhës të pellazgëve", por pak a shumë e lë të nënkuptohet.

Mbaj mend mirë takimet e mia me Kondën. Nuk e kisha njohur më parë. Ishte një plak thatim, që kishte një gjallëri, që të bënte përshtypje, për moshën që kishte. Perdja në sytë, tashmë e pandreqshme, i'a kishte errësuar disi të parit. Ecte me shkop dhe çuditërisht, jo fort i kërrusur nga vitet. Të bënte për vete me fjalët e tregimet e tij për jetën e tij të vegjëlisë e për atë të kohërave kur studionte e mbaroi në Athinë, për ato të luftës për liri e pavarësi dhe të mëvonshmen, nën regjimin obskurantist e shtypës të Ahmet Zogut etj. Menjëherë sapo mori vesh se unë isha nga Bregdeti më tha : "Kam qënë 8-10 vjeç, kur më merrte im atë që shkonte në ato anë si qymyrxhi e kujtoj gërxxhet e Pilurit, të Himarës etj."

Konda i lindur në vitet gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar, kishte jetuar e mësuar, shkurt ishte mbrujtur me diturinë e rilindasve tanë dhe krenaria për prejardhjen tonë pellazgjike i ishte rrënjësuar thellë në zëmër e në tru, që në moshën e tij më të njomë, çka e kishte shtytur, që të studionte me dashuri të veçantë shkrimtarët e vjetër grekë etj., që kishin folur për pellazgët.

- Rreth viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar - më tregonte në njërin nga takimet tona - iu drejtova një herë profesorit tim të dëgjuar Haxhidhaqit me këto fjalë : "Zoti profesor, si është e mundur që për deshifrimin e mbishkrimeve të pellazgëve ju keni përdorur sa e sa gjuhë e për gjuhën shqipe nuk menduat asnjëherë? Pse nuk keni bërë asnjë përpjekje për deshifrimin e mbishkrimeve që keni në bodrumet e Akropolis-it"? Pyetjes së parë Haxhidhaqi - vazhdoi Konda - i bëri bisht, për të dytën m'u gjegj kështu : Ah, more Spiro (Konda kishte qënë student i tij dhe në atë kohë kishte pak vjet që kishte mbaruar) për mbishkrimet e Akropolis-it u krijua nga lart disa vjet më parë një komision i posaçëm, por çështja prapë u la në heshtje. Nuk e lëmë këtë muhabet?".

Konda e tregonte këtë bashkëkuvëndim me profesorin e tij, duke dalë në përfundimin që qarqet reaksionare greke, çështjen e gjuhës shqipe e atë të prejardhjes së shqiptarëve nga pellazgët i urrenin e i luftonin në atë kohë. Konda fliste gjithashtu me urrejtje për regjimin e Ahmet Zogut, jo vetëm se i kishte shkaktuar mjerime të mëdha popullit, por edhe për pengesat që i kishte sjellë atij e për shpifjen që kishte përhapur për të. Konda kishte kërkuar nga ministri i arsimit të atëhershëm Xhafer Ypi, ndihmë për të shkruar rreth pellazgëve. Jo vetëm që nuk i kishte dhënë, por të kundërtën, e kishte cilësuar edhe si grekofil! Dhe me këtë rast Konda i nxehur tregonte, që gjatë luftës Italo-greke kur u pushtua Korça nga grekët, këta erdhën e kërkuar nga ai, si helenist, që kishte mbaruar universitetin e Athinës, të bashkëpunonte me ta. Ai u tha : "Unë kam mbaruar vërtet në Athinë, por kam qënë e mbetem shqiptar dhe jini drejtuar gabim tek unë. Korça ka qënë e do të jetë shqiptare". Kështu ata ikën e nuk u dukën më. Sigurisht grekët erdhën tek ai, jo vetëm se kishte mbaruar shkollën në Athinë, por nga cilësimi armiqësor që i kishte bërë regjimi i poshtër i Ahmet Zogut.

Konda fliste me urrejtje edhe për Faik Konicën, te cilit i qe drejtuar, që të pranonte të botoheshin në SHBA shkrimet e tij mbi pellazgët në gazetën "Dielli". Faik Konica nuk e kishte përfillur fare, sigurisht me udhëzimet e Xhafer Ypit.

Dhe plaku i mirë përmbyllte bashkëkuvëndimin: "tani jam i lumtur, Spiro, se Shqipëria është e popullit, falë udhëheqjes së Partisë e të Enver Hoxhës. Kështu u plotësua edhe

ëndrra e gjithë jetës sime, që të shkruaj i qetë e lirisht ato që kam mësuar e bluar tërë jetën për pellazgët. Të na rroje Partia me Enver Hoxhën në krye". Ishte gushti i 1955. Ndodhesha me punë në Korçë. Kisha rënë në Shtëpinë e Partisë (të vjetrën). Atje gjeta me pushime të nderuarin Prof. Aleksandër Xhuvani. Zakonisht kur shkoja në Korçë, takoja plakun Konda. Dhe asaj radhe Myftar Grabocka e njoftoi Kondën se unë e prisja pasdreke në Shtëpinë e Partisë. Rreth orës gjashtë erdhi. E pritja jashtë, para hyrjes, në hije. Sapo ishim ulur dhe kishim filluar kuvendimin. Ndërsa ai më pyeste për shëndetin e shokut Enver etj., zbriti Prof. Xhuvani nga kati i parë dhe doli tek hyrja, ku ishim ne të dy. Unë isha takuar me të pak më parë. Konda iu drejtua nga tryeza me ngrohtësi : "A je, si je Aleksandër?" dhe bëhej gati ta takonte. Prof. Xhuvani, duke qëndruar me këmbë e larg nesh, i'u përgjigj shumë ftohtë: "Mirë, Spiro!" dhe, pa i dhënë dorën e pa u ndalur fare, u largua. Ky qëndrim i Prof. Xhuvanit, ndërsa mua më habiti disi, Kondën e vrau, se uli kokën dhe heshti për ca kohë. Unë bëra sikur nuk kuptova gjë dhe vazhdova të flisja. Pasi u ndamë me Kondën vrava mëndjen : pse ky qëndrim kaq i ftohtë i Xhuvanit kundrejt Kondës? Këta kanë mbaruar të njëjtën shkollë, në të njëjtin vënd dhe kanë kaluar një jetë bashkë në Shqipëri me të njëjtat shqetësime, pavarësisht nga prodhimtaria e ndihmesa që i kanë dhënë çështjes së çlirimit nga pushtues e tradhëtarë. Xhuvani kishte vërtet prodhimtari të gjërë si lëvrues i gjuhës shqipe e merita të mëdha për ngritjen e zhvillimin e shkollës shqipe. Luftës Nacional-çlirimtare i kishte dhënë një djalë dëshmor dhe gjithë djemtë e vajzat e tij kishin qënë në radhët partizane. Për këto Partia i kishte besuar vënde me përgjegjësi. Konda nuk kishte të tilla merita, por nuk ishte as për t'u përçmuar. Kishte qënë njeri i ndershëm, arsimtar i përpjekur, njeri i lidhur me popullin e me luftën e tij. Për mendimin tim nuk meritonte kurrësesi ftohtesinë që mbajti Prof. Xhuvani me të. Kështu përfundova mendimin tim atë ditë dhe nuk e vrava mëndjen më tej.

Nga sa më kujtohet Konda kishte peng në zëmër një përmbyllje të Çabejt rreth prejardhjes së gjuhës shqipe, botuar në vitin 1935. Në vëll.III të "Studime gjuhësore" të Çabejt, në faqen 36, thuhet : "Duke përmbledhur ç'u tha këtu në lidhje me problemin e burimit të gjuhës shqipe, me çështjet që dalin përbrënda tij dhe me rrugët që janë ndjekur e metodat që janë zbatuar për të arritur në një zgjidhje, me një vështrim objektiv, do të thuhet se janë sqaruar disa anë, disa pika janë zbërthyer, po ky problem në thelb mbetet gjer më sot i pazgjidhur".

Konda ngulte këmbë se Çabej e kishte katërcipërisht gabim: gjuha shqipe vjen drejtpërdrejtë nga ilirishtja dhe s'ka vënd të ngatërrohet me trakishten. Ilirishtja vjen nga pellazgjishtja. E këtë synonte të vërtetonte Konda.

Puna e Kondës ecte me ritme të shpejta, se ai kishte shumë çështje e pjesë të hedhura në letër. Nga ana tjetër kishte një kujtesë të habitshme për atë moshë. Ai mbante mënd autorin, librin e faqen, ku trajtohej kjo ose ajo çështje, të cilën do të trajtonte dhe ai në veprën e tij. Siç duket kishte studiuar me vëmendje të madhe këta autorë e këto çështje dhe i ishin bërë gjak i gjakut të tij. Tani shtrohej çështja t'i përpunonte këto shënime e kujtesa dhe t'i rendiste, t'i zbërthente, t'i shtjellonte e t'i bashkërendonte në një vepër shkencore.

Në vitin 1956, aty nga mesi, Konda dha të shkruara, dorën e parë, pjesët "MBI TOPONIMINË" prej fjalëve të Homerit "gur, pyll e mal", që ai, duke i marrë si fjalë të përveçme, u ka vënë bri fjalët përkatëse greke "petra, dhasos e oros" si dhe "MBI ETRUSKËT". I studiova me kujdes edhe vetë, por nuk kishte asnjë rëndësi kjo. Rëndësi

kishte studimi nga ata që merren me këto çështje e kanë përvojën e aftësinë, për të dhënë gjykime e vlerësime. Dhe të tilla u dhanë nga shkencëtarët më në zë të Institutit të Historisë e Gjuhësisë.

Këndova dhe vetë këto gjykime e vlerësime dhe mbeta shumë i zhgënjyer. Ato në thelb nuk ishin objektive. Në tërësi e hidhnin poshtë si jo shkencore të gjithë punën e bërë deri atëhere nga Konda! Ndonjë kishte edhe theksime pak a shumë të tilla : "Është një tragjedi që një njeri me një këmbë në varr të merret me një problem kaq të madh!!" Gjuhëtarë e historianë ishin të gjithë në një mendim. Zhgënjimi im vinte nga ky arësytim : Si ka mundësi që në tërë këtë punë të lodhshme që ky filolog me përvojë ka bërë, këta shkencëtarët tanë nuk gjejnë asnjë gjë me vlerë? Po t'i kqyrim gjërat me objektivitet e pa paragjykime, llogjika e thjeshtë e lypte, që disa gjëra të qëndronin e një pjesë të rrëzohej. Por asgjë të tillë nuk kishte në ato katër-pesë gjykime e vlerësime. Kondës, natyrisht, nuk i'u tha gjë për këto. Ai vazhdoi punën. Dhe shoku Enver nuk e pakësoi aspak interesimin e ndihmën, që plaku Konda ta vazhdonte e ta mbaronte me qetësi punën. Natyrisht, ashtu si mua, edhe shokut Enver, këto gjykime e vlerësime aspak objektive, të kundërtën përçmuese, nuk i pëlqyen. E këtë e nxjerr nga ç'do të tregoj më poshtë.

Në mbledhjen e Kuvëndit Popullor të shkurtit 1957, siç duket nën vragën e zhgënjimit për gjykimet e vlerësimet, që i ishin bërë punës së deriatëherëshme të Kondës nga korifejtë (majat) e gjuhësisë e historisë, unë shkrova këtë vjershë dhe ia dërgova shokut Enver:

"DILEMA

Nga Pyrrua tek Skënderbeu
Edhe në kohërat më vonë,
Krenarinë tonë askush s'e theu:
- Që gjak pellazgu ndër neve vlon-
Shumë të huaj kanë punuar,
Këtë dilemë për ta zgjidhur:
"Pellazgët a kanë ekzistuar?"
Por jo "Kush me ta është i lidhur".
Dhe njëherë që memzi dolli
Një dijetar yni që i bashkon
Me popullin shqiptar, i polli
Të gjorit belaja! Shkenca jonë s'pranon!
Është i ulët, thotë, e primitiv;
Si bëhet pa Jokle, Mayer e tjerë?!
Fonetikën ay s'e di. Dënim definitiv?
Gjykata dha vendim të prerë.
Por historia do ta tregojë,
Se ka të drejtë Konda plak.
Lum ai që do të rrojë:
Të shohë si do hani dajak!
Arrëza"

18.2.1957

Shoku Enver në të njëjtën letër, ku ishte shkruar vjersha ime, është gjegjur me këtë vjershë :

Jam me ti, moj Arrëzo,
Pse ti je njeri i shkencës,
Pamvarësisht se thumba ke,
Dhe i del përpara pendës ,
Unë kam besim si ty,
Se kjo punë kështu do dalë.
Hypja kalit me shalë
Edhe shko e pi një dhallë
Me Çabenë e me Xhuvanë".

Grenxa

Duke ndjekur kronologjikisht zhvillimin e ngjarjeve, kemi këtë ndodhi kuptimplotë gjatë kohës që Spiro Konda punonte për veprën e tij.

Më 6 maj 1959, dy vjet pas vjershave të mësipërme, në mbledhjen e Byrosë Politike u morën në shqyrtim disa probleme themelore, që dolën nga rrahja e mendimeve rreth maketit të vëll. I të "Historisë së Shqipërisë". Neve, na ishte shpërndarë nga dy muaj përpara maketi, të cilin e kishim studiuar. Nga sa mbaj mend ndër çështjet parimore, që çalonin e të cilat u rrahën në këtë mbledhje, ishin:

1) Historia jonë fillonte me "kolonitë helene në bregdetin e Ilirisë", kaq sa dikush prej nesh bëri pyetjen: "historinë e kolonive helene shkruajmë apo historinë e Shqipërisë"?

2) Etnogjeneza e popullit tonë mbaronte tek ilirët! Asnjë fjalë nuk kishte për prejardhjen tonë nga pellazgët.

3) Vlerësimi i kryengritjes fshatare të Shqipërisë së Mesme nën udhëheqjen e Haxhi Qamilit nuk ishte i drejtë. Në se nuk gaboj edhe vlerësimi i Ali Pashë Tepelenën nuk ishte gjithashtu i drejtë.

Rreth çështjes pellazgjike a ishte kjo një harresë e rastit?

Me siguri jo. Kjo ishte rrjedhim i logjikës së mospranimit nga historianët tanë i tezës së rilindasve e të mjaft dijetarëve të tjerë që ilirët janë pasardhës të pellazgëve e si rrjedhim dhe shqiptarët si vazhdues (pasardhës) të ilirëve.

Mbi çështjen e pellazgëve, si paraardhës të tejlashtë të popullit tonë, shoku Enver Hoxha ndër të tjera tha :

"Çështja e popujve dhe e kulturave më të lashta, duke përfshirë edhe pellazgët, është studiuar nga historianë e dijetarë të ndryshëm, të cilët kanë pasur si qëllim të zbulojnë se si ka ardhur qytetërimi në botë. Në pikëpamjet e tyre ka rivalitete të ndryshme, duke synuar që grupe popujsh t'i vënë mbi të tjerët. Në përgjithësi ka ekzistuar pikpamja se në zhvillimin e kulturës kanë predominuar grupet më të mëdhenj, si kinezët, indianët, gjermanët, sllavët. Helenizmin e kanë mbrojtur të gjithë, kulturën e tij e kanë nxjerrë më të vjetër e më të përparuar, që i ka dhënë shkëlqim botës. Në bazë të këtyre tezave për popujt e tjerë është vënë një mur.

Megjithatë, sipas atyre që njihen si shkruesit e historisë së helenizmit, ndërmjet tyre është edhe Homeri, del se para helenëve kanë ekzistuar popuj të tjerë më të vjetër, një nga të cilët janë pellazgët.

Është fakt që pellazgët kanë ekzistuar, por asnjëri nuk është thelluar në këtë çështje nga pikëpamja arkeologjike dhe e gjuhës. Patriotët e shkrimtarët tanë si Naimi etj., disa historianë gjermanë etj., kanë thënë që populli ynë vjen nga pellazgët, po dokumenta të nevojshme, që të vërtetojnë këtë prejardhje, akoma nuk ka. Mendimet e historianëve gjermanë mund t'i quajmë progresiste përse i përket prejardhjes sonë nga pellazgët ...

Me sa kam lexuar unë shumë teza të tyre kanë dashur t'i hedhin poshtë, ndërsa ne, duke u nisur nga marksizëm-leninizmi, nuk mund të hedhim poshtë njerëz shumë të mësuar, idetë e të cilëve janë progresiste ...

... Ne nuk e shtrojmë çështjen nga ana nacionaliste e nuk themi që kemi qënë më të kulturuararit në botë, ose më të kulturuar se helenët, por themi se tjetër është kultura dhe tjetër është lashtësia e një populli.

Konda na ka dërguar artikullin e një shkrimtari grek, që thotë se pellazgët kanë ndihmuar në zhvillimin e kulturës helenike etj.. Këtë dhe faktin që pellazgët janë paraardhësit e shqiptareve, shokët tanë është e zorshme ta hedhin poshtë, duke paraqitur si argument vetëm se këto i kanë thënë edhe të tjerë. Ne nuk themi se Konda është origjinal, por nuk jemi as të mendimit që këto të hidhen poshtë.

Përsa i përket qytetërimit ilir, ne kemi fakte dhe të tjera do të zbulojmë me vonë...Tezën që ne vijmë nga pellazgët nuk duhet ta hedhim, por ta studiojmë më tej. Detyra e historianëve tanë është që të gjejnë lidhjet dhe zhvillimin e mëtejshëm të pellazgëve me ilirët. Tani nuk shtrohet si më parë çështja e ekzistences së popullit shqiptar si komb, por problemi i prejardhjes duhet të zgjidhet shkencërisht, pra tezat që ngrihen të shpjegohen me dokumente. Ne nuk jemi specialistë, por mendime mund të shfaqim.

Prandaj unë do të propozoja që teza, që ne vijmë nga pellazgët, duhet të studiohet e të argumentohet, sepse ky problem nuk është zgjidhur përfundimisht, ndërsa çështja e ilirëve si stërgjyshër të popullit shqiptar, është e provuar, megjithëse lidhja midis tyre, midis pellazgëve e ilirëve mbetet për t'u vërtetuar",

Vërejtjet e Byrosë Politike u pasqyruan në përpunimin përfundimtar të vëll. I të Historisë së Shqipërisë.

Gjatë viteve 1957-1959 ngurova të takohesha me Çabejn e Xhuvanin, siç më këshillonte, si me shaka, shoku Enver Hoxha në vjershën që përmenda më sipër, sepse nga qëndrimi i tyre kundrejt Kondës arrija në përfundimin, se me mua ata nuk do të luanin kurrësesi nga qëndrimi i tyre, pse unë nuk isha filolog e ca më pak i aftë t'i bindja, që nuk e kishin drejt. Kur foli shoku Enver më gjashtë maj në Byronë Politike rreth çështjes së prejardhjes sonë nga pellazgët e mbrojtë në një farë mënyre, edhe Kondën, unë ndjeva një gëzim të madh dhe e quajta veten tashmë të liruar nga barra që më kishte ngarkuar. Pas këtij zbërthimi të tezës pellazgjike nga shoku Enver - thashë me vete - sigurisht shkencëtarët tanë do të hidhen në kërkime e studime, sipas orientimeve që dha udhëheqësi ynë për këtë çështje të madhe.

Në vitin 1962 u botua në greqisht vepra e Kondës "Shqiptarët dhe problemi pellazgjik". Botimi shqip doli pas dy vjetëve. Në fund të vitit 1961 doli nga shtypi (në Shqipëri erdhi në vitin 1962) vepra e arkeologut të diplomuar në universitetin e Parisit, Zaharia Mayanit "Etruskët nisën të flasin". Për ne kjo vepër ishte një ngjarje me rëndësi, se autori si çelës të zbërthimit të gjuhës së etruskëve kishte zbuluar gjuhën shqipe. Më kujtohet si shoku Enver e pas tij unë e ndonjë tjetër, e studiuam me vëmendje e kënaqësi të veçantë këtë vepër që e ngrinte lart gjuhën tonë, për lashtësinë dhe pasurinë e qëndrueshmërinë e saj. Etruskologët italianë i'u vunë kundra menjëherë, pse ata kanë mbrojtur e mbrojnë edhe sot tezën se etruskët janë popull italian, çka do të thotë që qytetërimi etrusk, që i kaloi Romës, së themeluar nga vetë etruskët, është një qytetërim i lindur në Itali dhe jo i çuar atje nga një popull tjetër.

Në Konferencën Albanologjike, të mbajtur në nëntor 1962, u ftuan edhe Spiro Konda e Zaharia Mayani. I pari foli mbi temën "Shqiptarët dhe problemi pellazgjik" dhe i dyti mbi temën "Etruskishtja dhe shqipja".

Vitet kalonin dhe asgjë nuk pipëtinte nga rrethet shkencore të gjuhësisë e të historisë të vëndit tonë rreth këtyre dy veprave të shënuara. Ndërsa vepra e Mayanit, sipas Radio Romës (njoftim i dhënë nga ATSH, i marrë nga Radio Roma më 2 shkurt 1971), ishte përkthyer në anglisht, rusisht, gjermanisht etj. etj. në gjuhën shqipe nuk u përkthye! Ç'ironi! Kyçi i një gjuhe, që për shumë shekuj kishte mbetur mister, ishte gjuha shqipe dhe vepra në shqip nuk u përkthye! Rrethet shkencore të vëndit tonë dënuan me HESHTJEN E TYRE si veprën e Kondës, ashtu edhe atë të Mayanit.

Pas afro dhjetë vjetëve, në fund të vitit 1970, Zaharia Mayani botoi veprën e tij të dytë "Fundi i misterit etrusk", e cila në vitin 1973 u botua e përkthyer në shqip nga ne. Autori, ndër të tjera, boton edhe një pjesë të letrave që kishte marrë nga albanologë e dijetarë të dëgjuar rreth veprës së parë "Etruskët nisën të flasin".

Asgjë nga shqiptarët, veç ftesës për të folur në Konferencën Albanologjike!

Edhe kundrejt veprës së dytë të Mayanit u mbajt i njëjti qëndrim, si ai kundrejt së parës, nga rrethet shkencore të gjuhësisë e të historisë në vëndin tonë: HESHTJE, HESHTJE

...

Në Vitin 1981 në Itali u botua vepra e Enzo Gattit "Ilirët" në dy vëllime. Edhe për këtë vepër, që flet për ilirët në siujdhesën italice, i njëjti qëndrim nga rrethet shkencore të gjuhësisë e të historisë në vëndin tonë: HESHTJE, HESHTJE ...

Këto janë vepra, që kanë lidhje me të kaluarën e qytetërimit e popullit tonë, të shkruar nga të huaj, të cilët ndonëse nuk janë shkencëtarë të përkryer si N. Jokli, G. Mayer etj., janë të paktën miq sa dhe ata, të popullit tonë dhe e nderojnë, duke folur për lashtësinë e tij dhe qytetërimin, që u ka dhënë dikur të tjerëve. Do ishte detyra jonë, madje domosdoshmëri, bërja e një shkrimi nga shkencëtarët tanë në revistat "Studime historike" ose "Studime filologjike" rreth këtyre veprave, për të vënë në dijeni vetë popullin tonë, se ç'shkruset në botë mbi lashtësinë e tij.

Është për të ardhur keq, që një gjuhëtar si Eqerem Çabej të ketë ndikuar kaq shumë negativisht në hedhjen poshtë të krenarisë tonë kombëtare, si pasardhës të pellazgëve, me tezat e tij pa baza shkencore, që pohojnë të kundërtën. Jam i mendimit që kjo veprimtari e tij ka dëmtuar deri njëfarë pike, edhe vetë veprën e tij madhore mbi etimologjinë e fjalëve të gjuhës sonë. Duke mos e lidhur gjuhën tonë me gjuhën pellazgjishte, por vetëm me gjuhën e ilirëve, kjo e ka çuar, që në prejardhjen e fjalëve ai të anojë më shumë në huazimet e gjuhës sonë nga greqishtja e latinishtja e të zbehë të kundërtën, pra fjalët që i ka huajtur gjuha jonë këtyre gjuhëve, të cilat janë dukur e zhvilluar pas pellazgëve e në truallin e tyre.

Ja ç'thotë ai në faqet 43-44 të vëll. "Studime gjuhësore" (Botim i "Rilindjes" Prishtinë 1976) :

"Më 1854 Hahni, dijetari që shikohet me të drejtë si ati i albanistikës, tezën e tij rreth burimit ilir të shqiptarëve e të shqipes e zgjeroi me anën e një vështrimi edhe të situatës etnografike të Ballkanit të vjetër. Në lidhje me atë ai në kryeveprën e tij "Albanische Studien" (I 215) formuloi këto teza:

1. Epirotët e Maqedonët edhe në kohë të Strabonit ishin jogrekë ose barbarë;

2. Epirotët, Maqedonët e Ilirët janë farefis në mes tyre;

3.Ka shumë shënja që Epirotët e Maqedonët përbënin thelbin e fisit tireno-pellazgjik, skajet më të tutjeme të cilit në Itali e në Traki hyjnë brënda në histori;

4. Ilirishtja është gjuhë pellazgjike, në një kuptim më të gjerë.

Me këto teza Hahni të Ilirët, si të parët e shqiptarëve, përfshin edhe Epirotët e Maqedonët, e të gjithë këta popuj i bën të ardhur prej pellazgëve". Dhe ja mendimet e Çabejt rreth tezave të Hahnit :

"Teoria e Hahnit si tërësi, me gjëndjen e sotme të kërkimeve arkeologjike e gjuhësore, në disa anë del e drejtë, në disa përgjithësime që bën nuk mund të qëndrojë, po në analizë të fundit përmban një thelb pjellor të vërtetë. Teza e tij që Epirotët e Maqedonët nuk ishin grekë, vërtetohet prej dëshmive të vetë autorëve helenë, dhe vetëm një dije jo objektive e shoviniste mund të vazhdojë të qëndrojë në pikëpamjen e përkundërt. Teza e afërisë së Epirotëve, Maqedonëve e Ilirëve në mes tyre është një mendim i pranuar pothuajse gjithkund, sepse ato të pakta dëshmi që kanë mbetur nga gjuhët e këtyre popujve flasin qartë për një të tillë afëri.

Teza që Epirotët e Maqedonët përbënin thelbin e fisit tireno-pellazgjik e që ilirishtja është pellazgjishte në një kuptim më të gjerë, në këtë vështrim të përgjithësuar, nuk mund të mbahet, sepse pas gjithë gjasave ILIRISHTJA E PELLAZGJISHTJA JANË GJUHË TË NDRYSHME (nënvizimi me shkronja të mëdha është imi).

Karakter i gjuhësor i ilirishtes e përkatësia e saj në trungun indo-europian u pa më lart. Për karakterin gjuhësor të pellazgjishtes, për mungesë të një materiali që mund të thuhej me siguri se i përket asaj gjuhe, dija nuk ka arritur në qartësi. Nuk mund të caktohet me siguri cilës familje ose shtrese gjuhësore i përkiste. Hahni as që e shtroi pyetjen në se pellazgjishtja është gjuhë indoeuropiane apo jo, e kjo është e natyrshme për një kohë (1854), në të cilën gjuhësia indoeuropiane e krahasuar sapo kishte marrë hapat e para".

Çabej është në kundërshtim me vetveten! Si mund të pohojë me kaq vendosmëri, se ilirishtja e pellazgjishtja janë gjuhë të ndryshme, kur pellazgjishtja nuk njihet, sipas tij, se mungon një material, që mund të thuhej me siguri se i përket asaj gjuhe e nuk mund të caktohet me siguri se cilës familje ose shtrese gjuhësore i përkiste. Këtu jemi para një absurditeti! Si mund të krahasohen dy sende, dy madhësi ose edhe dy gjuhë e të thuhet se nuk janë të barabarta, kur njëra nuk njihet!?

Por me këtë tezë Çabej ka hedhur poshtë si pa baza pohimin prej shekujsh të popullit tonë, pohimin e rilindasve tanë, se ne jemi pasardhës të pellazgëve e ilirët pasardhës të drejtpërdrejtë të tyre. Pikërisht me këtë tezë e me autoritetin e tij Çabej ka ushtruar ndikimin më negativ të mundshëm në gjuhëtarë e historianë, për të mos bërë studime e kërkime për të vërtetuar tezën e prejardhjes sonë nga pellazgët.

Për sa i përket pyetjes, që nuk i bëri Hahni vetes, është apo jo pellazgjishtja gjuhë indoeuropiane, këtë pyetje e kanë bërë shumë dijetarë të shekullit të kaluar e të shekullit tonë, që janë marrë me problemin pellazgjik, dhe shumica kanë përfunduar me vërtetimin se pellazgjishtja është një gjuhë indoeuropiane. Ndër këta përmend disa nga më të rinjtë, Georgiev (bullgar), Sakellariu (grek), Fritz Lochner - Hüttenbach (austriak) etj..

Dhe në fund Çabej del me këtë përmbyllje të çuditshme "ex cathedra":

"Shkrimtarët shqiptarë të kohës së Rilindjes e rrokën me entuziazëm këtë ide të Hahnit dhe i dhanë përhapje në librat e tyre". Më sipër thashë "të çuditshme", se nuk mund ta besoj që Çabej të mos njihte traditën e popullit tonë dhe krijimtarinë e rilindasve tanë.

Por do të thoshja se kjo përmbyllje tingëllon disi fyese kundrejt veprës së tyre. Si qëndron e vërteta?

Më 1840 Jeronim De Rada doli me studimin e tij "Mbi hyjnitë e pellazgëve". Kjo vepër bëri bujë dhe u përhap si rrufeja (krahasuar me mundësitë e mjetet e kohës) jo vetëm tek shqiptarët, por edhe tek rrethet shkencore e kulturore të Evropës. Naum Veqilharxhi në Enciklikën (letër qarkore) të 1846, u rekomandon shqiptarëve studimin e De Radës "Mbi hyjnitë e pellazgëve" që e kishte botuar në vitin 1840 e që u ribotua nën titullin "Lashtësia e popullit shqiptar" në Athinë në vitin 1845 e në Bukuresht në vitin 1946: "Po i këshilloj atdhetarët tanë, që duan atdheun, të vështrojnë me kujdes një studim të ri filologjik"... si një vepër që meriton vëmendje shumë të madhe, aq më tepër, pasi kjo ka lidhje me shqiptarët".

Këto radhë janë nxjerrë nga një artikull i Myslim Islamit në revistën "Nëntori" nr. 10, viti 1987 (f.125-131). Myslim Islami është autori i biografisë "Naum Panajot Bredhi VEQILHARXHI" botuar në vitin 1967.

A mund të flitet pra se "rilindasit e rrokën me entuziazëm këtë ide të Hahnit" kur ata kishin shkruar e botuar mbi prejardhjen e shqiptarëve nga pellazgët 14 vjet përpara se të dilte Hahni me "Albanische Studien"?

A mund të flitet se shkrimtarët e Rilindjes morën nga Hahni idenë, kur nëntë vjet para, se të delte vepra e Hahnit, në Athinë botohej studimi i De Radës, me titull "Lashtësia e popullit shqiptar dhe 8 vjet para Hahnit në Bukuresht po ky studim?!?"

Është e kundërta ajo që ka ndodhur : Hahni, i cili kaloi disa vjet në Janinë, afër Dodonës së lashtë, si konsull i Austrisë, jo vetëm që e ka dëgjuar, sa e sa herë nga shqiptarët, e, sigurisht nga vetë Ali Pashë Tepelena, se populli shqiptar është pasardhës i pellazgëve, po kur u njoh me studimin e De Radës u frymëzua dhe i'u vu studimit mbi këtë çështje dhe pas 8-10 vjet doli me veprën e tij të njohur.

Populli ynë, sigurisht, si në kohën e pellazgëve edhe në atë të Ilirëve, epirotëve etj. ka shkruar, por luftrat e stuhitë shekullore kanë zhdukur çdo gjurmë të këtyre shkrimeve, Veç një gjë nuk kanë mundur të zhdukin rrebeshet e historisë, qytetërimin e të parëve tanë, në të cilin bën pjesë ajo e kalimit të vetive të çmueshme të trashëguara nga të parët, nga ati tek biri, nga nëna tek vajza, nga brezi tek brezi. Kështu ka ardhur deri tek rilindasit e tek ne tradita se ne e kemi prejardhjen nga pellazgët. Dhe kjo u hodh edhe në shkrime tek arbëreshët e Italisë, pasardhës të oinotrëve pellazgë e të arbëreshëve të kohës së Skënderbeut, që gjetën strehim e u ngulën në ato vende, të cilat i kanë ruajtur si gjërat më të shënjtat traditat e të parëve tanë.

Në ndihmë të kësaj tradite të popullit tonë vjen edhe artikulli i Prof. Mahir Domit "Arbëreshët për prejardhjen e shqipes e të popullit shqiptar" botuar në të përjavshmen "Drita" më 1 gusht 1982.

Në këtë studim, veç të tjerave, M.Domi ndalet tek Nikollë Keta (1740-1803) dhe tek Engjëll Mashit (fundit i shek. XVIII e fillimi i XIX)

Idetë e shprehura në dorëshkrime të studiuesve para tij përpunohen dhe shtjellohen në një teori të tërë prej autorit arbëresh Nikoll Keta. "Puna e tij prej pionieri është pak e njohur edhe për faktin se vepra e tij (1777) mbeti dorëshkrim dhe pak kush pati rast ta lexojë. Kontributi i këtij autori në studimet historike e gjuhësore shqiptare meriton të njihet më gjerë dhe të vlerësohet si duhet. Nikollë Keta ngrihet mbi të gjithë autorët e mëparshëm arbëreshë nga gjërsia dhe niveli i trajtimit, nga ndjenja e qartë patriotike që e frymëzon, çka i jep atij vendin e një pararendësi...

Nikollë Keta i lidh shqiptarët me banorët më të parë të Ballkanit, që përmend historia, me pellazgët. Me këtë ai është, mund të themi - vazhdon M.Domi - autori i së parës teori të kristalizuar të prejardhjes pellazge të shqiptarëve, teori që do të rimerrej nga studiues të tjerë arbëreshë e do të popullarizohet një shekull e gjysmë më pas, sidomos në veprimtarinë e Jeronim De Radës e të ndonjë studiuesi tjetër arbëresh ...

Ndër arbëreshët që e përqaftuan dhe e shtjelluan teorinë pellazge mund të përmenden Zef Krispi (1831), V.Dorsa (1843), Dh.Kamarda e sidomos poeti i madh i letërsisë arbëreshe e shqiptare, Jeronim De Rada. Ky shkroi që më 1840 një artikull, ku orvatej të provonte prejardhjen e shqiptarëve prej pellazgëve të lashtë ...

Vështrimi i shpejtë që parashtroam tregon qartë se vetë shqiptarët prej kohësh janë interesuar gjallërisht për historinë e tyre e të gjuhës së tyre. Përsa i përket fillimeve të veprimtarisë studimore në këtë fushë arbëreshët kanë qënë ndër të parët. Ata kanë dhënë kontribute me rëndësi ..." mbaron M.Domi.

Përmbyllje e kundërt për çka thotë Çabej.

Me gjithë heshtjen e gjatë të rretheve shkencore të gjuhësisë e të historisë për këtë çështje, orientimet e qarta, për mos hedhjen poshtë të tezës së prejardhjes pellazge të popullit tonë, por për vërtetimin shkencor të saj, të 6 majit 1959, të shokut Enver Hoxha, i kanë dhënë shtytje një sërë studimeve e kërkimeve shkencore në fushën e arkeologjisë e në botimin e një sërë biografish, si të Jeronim De Radës nga Jup Kastrati, të Pashko Vasës nga Vehbi Bala, të Naum Veqilharxhit nga Myslim Islami etj. dhe të disa artikujve të rëndësishëm, si ai që përmenda më sipër, të Muzafer Xhaxhiut etj., të cilët na kanë ndriçuar e hapur horizont edhe ne të tjerëve, që nuk jemi të zanatit, por e kemi merak këtë çështje, ashtu si çdo shqiptar. Falë këtyre studiuesve, mund të shprehim edhe ne ndonjë mendim të bazuar në studime shkencore.

Meritë të veçantë kanë në këtë fushë arkeologët tanë të shquar Selim Islami e Muzafer Korkuti dhe ndonjë tjetër, pas tyre. Arkelogu Selim Islami në intervistën e dhënë korrespondentit të ATSH-së, botuar më 31 tetor 1963 në shtypin tonë, ndër të tjera ka thënë :

"Gërmimet e viteve të kaluara kishin treguar se këtu kishim të bënim me vendbanim të kohës së bakrit të tipit palafit ... dhe me një tjetër më të vonë të kohës së bronzit ...

Gërmimet e sivjetshme e sqaruan edhe më mirë moshën dhe karakterin e këtij vendbanimi: ato vërtetuan edhe njëherë lidhjen gjenetike midis shtresës kulturore të kohës së bakrit dhe të asaj të bronzit, që paraqitet me të gjitha tiparet e një kulture të formuar ilire. Ajo nuk është diçka e re, e ardhur dhe e depozituar mbi gërmadhat kulturore të një popullsie të mëparshme vendase, por përkundrazi një kulturë e lidhur gjenetikisht me atë të epokës së bakrit, një kulturë e lindur prej saj. Gjetjet e reja treguan edhe më qartë lidhjet e kësaj kulture me ato të epokave përkatëse të siujdhesës Ballkanike dhe në radhë të parë me kulturat fqinjë të Maqedonisë, Thesalisë dhe deri diku, me ato të Mesdheut Lindor, atdheut klasik të asaj popullsie proto indoeuropiane, që njihet në traditën e shkruar historike me emrin e pellazgëve.

Këto vrojtime janë duke tërhequr vëmendjen e studiuesve tanë drejt mundësive të një shqyrtimi të ri të problemit të gjenezës së të parëve të popullit tonë, të ilirëve dhe lidhjet e tyre me substratin pellazgjik".

Dhe pas 21 vjetëve arkelogu Muzafer Korkuti në një artikull, me emërtimin "Arkelogjia dhe problemi pellazgjik", botuar në revistën "Shkenca dhe jeta" nr. 2 vi ti 1984, në fund jep këto përmbyllje :

"Zgjidhja e problemit të banorëve të stërlashtë të vendit tonë, nuk merr fund me përcaktimin e karakterit indoeuropian të banorëve të tërësisë ballkano-egjeane e me emërtimin e tyre si pellazgë. Që zgjidhja të çohet deri në fund duhet të përcaktohen edhe lidhjet e pellazgëve e të pellazgjishtes me banorët e trevës së Ballkanit Perëndimor në epokën e bronzit të hershëm, domethënë me ilirët dhe ilirishten". Korkuti mendon se ky problem i rëndësishëm kërkon trajtim të veçantë. Për këtë ai hedh këto të dy ide :

"Së pari : duhen marrë në shqyrtim ato të dhëna, edhe pse të kufizuara, që vijnë nga fusha a toponimisë së lashtë të Ballkanit dhe ato fjalë jo greke që gjenden në greqishten e vjetër, të cilat i takojnë nënshtresës pellazgjishte e shtjellohen dhe lidhen me ilirishten. Së dyti : të mbështeten e të interpretohen historikisht të dhënat arkeogjike. Kanë rëndësi të dorës së parë lidhjet kulturore dhe etnike midis kulturës së epokës së bakrit (eneoliti), bartësit e së cilës janë pellazgët, me kulturën e bartësit të epokës së bronzit të hershëm të vendit tonë.

Të dhënat që janë zbuluar në Maliq, në Tren, në Shpellën e Nezirit e, kohët e fundit, në Shpellën e Bënjës, dëshmojnë se ka një lidhje të ngushtë kulturore midis dy epokave, gjë që nënkupton edhe një lidhje etnike, krahas sendeve të reja kulturore (qeramikë me sipërfaqe të ashpër). Si rrjedhim në mbrujtjen e kulturës së bronzit, vetëvetiu edhe të bartësve të saj, ka një përbërës të ri, që lidhet me ardhjen e popujve indoeuropianë (bartës të qeramikës me sipërfaqe të ashpër) e një përbërës të fuqishëm kulturor dhe etnik, të trashëguar nga epoka eneolitike, atë pellazgjik".

Përzgjedhi për botim Dilaver Goxhaj